



Të Reja ▾

Policia e Shtetit ▾

Shërbime ▾

Baza ligjore

Vendndodhjet e policisë

Video

Programi i transparencës ▾

Kontakt

Lajmet e Fundit:

Tiranë – Denoncimi nga qytetarët në Komisariatin Dixhital dhe reagimi i menjëhershëm i shërbimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 vënë në pranga 27-vjeçarin



Lajmet Njoftime Operacionet

02/05/2020

Pukë – Qarkullonte me armë zjarri, vihet në pranga 34-vjeçari. Sekuestrohet 1 armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

34-vjeçari, i dënuar më parë për vjedhje dhe dhunë në familje.

Shërbimet e Policisë, krahas angazhimit 24 orë për monitorimin e zbatimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19, vijojnë punën për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë.

Nga shërbimet e Komisariatit të Policisë Pukë, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative se një shtetas në fshatin Bicaj lëvizte me armë, u organizua puna për identifikimin dhe kapjen e tij.

Si rezultat i një pune të mirëorganizuar u evidentua shtetasi F. Sh., 34 vjeç, banues në fshatin Bicaj, Pukë, i cili lëvizte me armë zjarri me vete dhe në momentin që ka parë shërbimet e Policisë ka hedhur armën dhe ka tentuar të largohet, por është kapur gjatë ndjekjes nga shërbimet e Policisë.

Në përfundim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimeve u bë arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi, si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit tip TT dhe municioni luftarak.

Materialet procedurale në ngarkim të tij i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.

WhatsApp Share

Facebook Share

Twitter Share

LinkedIn Share

Email

◀ Tiranë – Kapet dhe arrestohet nga DVP Tiranë, 38-vjeçari i kërkuar nga drejtësia italiane për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve në sasi të mëdha, kryer në bashkëpunim”.

Tiranë – Zbardhet ngjarja e ndodhur më datë 30 prill 2020, në fshatin Qinam, ku persona të paidentifikuar, nën kërcënimin e armës, vodhën një sasi lekësh në banesën e shtetasis B. Z. Identifikohen, lokalizohen dhe arrestohen nga Policia tre autorët. ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent